



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Novatech Studio” shpk
Adresa: Tirane, Rruga “Shenasi Dishnica” hyrja 1 Ap 18.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kerkese per propozim”- Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Modernizimi i Dhomës së Serverave në Bashkinë Tiranë”.

Referenca e procedures: REF-83100-08-16-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Mbikqyrje e punimeve per objektin: “Modernizimi i Dhomës së Serverave në Bashkinë Tiranë”.

Fondi limit: 655.916 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në mbështetje të VKB Nr.132, datë 21.12.2017 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për Vitin 2018” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, afati 3 (tre) muaj .

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 27.08.2018 ora 11.00

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 33 datë 20 Gusht 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara.

1. Operatori ekonomik “Novatch Studio” shpk

NUIS L01717030C

Vlera e ofertës – **556.336 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “M.A.K Studio ” shpk

NUIS L01422017O

Vlera e ofertës – **533.000 (pesëqind e tridhjetë e tre mijë)** lekë pa TVSH.

Është s’kualifikuar Operatori ekonomik i mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “M.A.K Studio ” shpk nuk kualifikohet.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “M.A.K Studio ” shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “**MAK Studio” shpk**, konstatoi se, ky operator nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor sipas grupeve të tarifore.

Autoriteti Kontraktor në datën 17.08.2018, në shtojcën 10, bashkëngjitur Dokumentave Standarte të Tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, të reflektuar në sistemin elektronik të APP-se, ka kërkuar si më poshtë vijon:

Mbeshtetur në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe në mbështetje të udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik datë 25.07.2017, prot 5585 “Rekomandim mbi mënyrën e percaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Operatori ekonomik do të s’kualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016, në varesi të kategorisë dhe grupit tarifor ku bën pjesë objekti i prokurimit).

Shënim:

Operatorët ekonomike gjatë përparimit të ofertës ekonomike në përlogaritjen e vlerës së mbikëqyrjes së punimeve për objektin “Modernizimi i dhomes së serverave në Bashkinë Tiranë” duhet të mbajnë parasysh se :

- **Fondi limit i objektit (Nderim-Montim) “Modernizimi i dhomes së serverave në Bashkinë e Tiranës” është: 42.000.232 (dyzet e dy milion e dyqind e tridhjetë e**

dy) lekë pa TVSH ne te cilen nuk eshte e perfshire vlera e zerit “Mirembajtje te DATA CENTER me të gjithë sistemet” pjese e preventivit te objektit te prokurimit “Modernizimi i dhomes se serverave ne Bashkine Tirane”.

- **Vlera e Ndërtim – Montimit te punimeve teknike**, mbeshtetur në VKM 354, datë 11.05.2016, Seksioni II “Sistemet Teknike”, përkatësisht në Nenin 56, Tabela e tarifave për sistemet teknike, eshte e perfshire ne Grupin e II Tarifor.
- **Vlera e Ndërtim – Montimit te punimeve civile** mbeshtetur në VKM 354, datë 11.05.2016, Seksioni I “Ndërtesa dhe ndarjet funksionale të tyre”, përkatësisht në Nenin 26, Tabela e tarifave për shërbimet lidhur me ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre, eshte e perfshire ne Grupin e IV Tarifor.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit te paraqitur nga ky operator ekonomik konstatoi se Oferta e Operatorit Ekonomik “MAK Studio”shpk, rezulton nen minimumin e lejuar te perllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, ne baze te VKM nr.354, date 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se :

“Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuar nga ky manual”

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të perllogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Modernizimi i dhomes se serverave”.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “MAK Studio” shpk, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “Novatech StudioM” shpk** me adresë: Tirane, Rruga “Shenasi Dishnica” hyrja 1 Ap 18se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **556.336 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.08.2018.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

